



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 57

Korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.315, datë 25.5.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.8, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar”	3
Vendim i KM nr.362, datë 20.6.2007	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Microsoft Corporation”, për projektin e partneritetit strategjik, në fushën e teknologjisë së informacionit	3
Vendim i KM nr.363, datë 6.6.2007	Për miratimin e ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit, të formës “BOT” për hidrocentralin e Kalivaçit, ndërmjet organit shtetëror të autorizuar, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe shoqërisë koncesionare BEG, S.p.A.....	4
Vendim i KM nr.380, datë 20.6.2007	Për miratimin e planit të shtatë të masave për sektorin e energjisë elektrike për vitet 2007-2009	4
Vendim i KM nr.391, datë 28.6.2007	Për lirin dhe caktimin e administratorëve të shoqërive huamarrëse në administrim	5
Vendim i KM nr.392, datë 28.6.2007	Për lirim dhe emërim në detyrë	5
Vendim i KM nr.395, datë 28.6.2007	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit, ndërtesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	6
Vendim i KM nr.404, datë 11.7.2007	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Polonisë, për bashkëpunimin ekonomik	6

Vendim i KM nr.409, datë 11.7.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kryera, për trajtimin shëndetësor, në Turqi, të së ndjerës znj. Lorena Drenofci	7
Vendim i KM nr.462, datë 18.7.2007	Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë	7
Vendim i KM nr.465, datë 18.7.2007	Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	8
Vendim i KM nr.479, datë 2.8.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve për kurimin, në Itali, të z.Bashkim Gazidede	8
Vendim i KM nr.485, datë 25.7.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kryerjen e transplantit të veshkës së znj.Erma Zagorçani, në Pakistan ...	9
Vendim i KM nr.487, datë 25.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.404, datë 24.10.1991 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e personaliteteve të larta shtetërore”, të ndryshuar	9
Vendim i KM nr.510, datë 8.8.2007	Për dhënien në përdorim Avokatit të Prokurimeve Publike të disa mjediseve të ndërtesës (Godinës) së ish-INIMA-s	10
Vendim i KM nr.515, datë 15.8.2007	Për miratimin e marrëveshjes minerare të shfrytëzimit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Cementos Aguila” sh.p.k.....	12
Vendim i KM nr.518, datë 25.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.590, datë 22.12.1997 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e dy anëtarëve në këshillin administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, të ndryshuar...	20
Vendim i KM nr. 519, datë 25.7.2007	Për miratimin e marrëveshjes minerare të shfrytëzimit.....	20
Vendim i KM nr.526, datë 22.8.2007	Për funksionimin e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet me Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO)	21
Vendim i KM nr.527, datë 27.8.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar.....	22
Vendim i KM nr.532, datë 28.8.2007	Për një shtesë në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	22
Vendim i KM nr.539, datë 22.8.2007	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, për zhvillimin e autostradave të deteve në rajonin e BSEC	23

Vendim i KM nr.540, datë 22.8.2007	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverive të Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Moldavisë, Republikës së Malit të Zi, Rumanisë dhe Republikës së Serbisë “Për bashkëpunimin në luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet nismës antikorrupsion të Europës Juglindore”	23
Vendim i KM nr.542, datë 22.8.2007	Për ekzekutimin e vendimit nr.35853/04, datë 12.12.2006 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen “Bajrami kundër Shqipërisë”	26
Vendim i KM nr.544, datë 15.8.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për statusin “Dëshmor i Atdheut””, të ndryshuar	27
Vendim i KM nr.556, datë 29.8.2007	Për lirim dhe emërim në detyrë	28
Vendim i KM nr.557, datë 29.8.2007	Për emërim në detyrë	28
Vendim i KM nr.558, datë 19.7.2007	Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në disa qarqe të vendit, për shkak të zjarreve masive në pyje	28
Vendim i KM nr.565, datë 5.9.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e z.Artur Mici, në Itali	29
Vendim i KM nr.570, datë 5.9.2007	Për dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit Avni Halit Durici	30
Vendim i KM nr.572, datë 5.9.2007	Për dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit Besnik Ahmet Alliu	30
Vendim i KM nr.573, datë 5.9.2007	Për dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit Zaim Haki Hysa ..	31
Vendim i KM nr.574, datë 5.9.2007	Për dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit Mehdi Laim Jani .	31
Vendim i KM nr.575, datë 5.9.2007	Për dhënie ndihme financiare familjes së shtetasit Hysen Haqif Lezi	32
Vendim i KM nr.583, datë 5.9.2007	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Lituaniës, për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve	32
Vendim i KM nr.585, datë 5.9.2007	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, për bashkëpunimin për zhvillim	33

VENDIM
Nr.315, datë 25.5.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.8, DATË 7.1.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME
AFTËSI TË KUFIZUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në strategjinë, që i bashkëlidhet vendimit nr.8, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave, në pikën 1 “Këshilli Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar”, në nënndarjen “Anëtarët”, në rreshtin e fundit fjalët “4 OJQ Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar” zëvendësohen me “5 Shoqata Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.362, datë 20.6.2007

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË MIKROSOFT CORPORATION, PËR
PROJEKTIN E PARTNERITETIT STRATEGJIK, NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë Microsoft Corporation, për projektin e partneritetit strategjik, në fushën e teknologjisë së informacionit.

2. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Financave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.363, datë 6.6.2007

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT” PËR HIDROCENTRALIN E KALIVAÇIT, NDËRMJET ORGANIT SHTETËROR TË AUTORIZUAR, MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, DHE SHOQËRISË KONCESIONARE BEG, SPA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8708, datë 1.12.2000 “Për përjashtime dhe dhënien e disa stimuljve për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit”, dhe të nenit 35 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit, të formës “BOT” për hidrocentralin e Kalivaçit, ndërmjet organit shtetëror të autorizuar, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe shoqërisë koncesionare BEG, SpA.

2. Pikat 2, 4 e 5 të vendimit nr.222, datë 24.5.1997 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOT”, për HEC-in e Kalivaçit”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.380, datë 20.6.2007

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHTATË TË MASAVE PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITET 2007-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shtatë të masave, për sektorin e energjisë elektrike, për vitet 2007-2009, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.42, datë 13.1.2006 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të gjashtë të masave, për sektorin e energjisë elektrike, për vitet 2006-2008”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.391, datë 28.6.2007

**PËR LIRIMIN DHE CAKTIMIN E ADMINISTRATORËVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE
NË ADMINISTRIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7/2 e 7/8 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1 Z.Ymer Liksala lirohet nga detyra e administratorit të shoqërive huamarrëse, në administrim “Kamberi & Co”, “M.Leka”, “Global Foods”, “Fabiona”, “Univers”, “Arsed”, “Beno”, “Nahlel” dhe të fondacioneve “Populli” e “Xhaferri”.

2. Znj. Daniela Riska lirohet nga detyra e administratorit të shoqërive huamarrëse, në administrim “Silva” dhe “Cenaj & Co”.

3. Znj. Yllka Sejati, administratore e shoqërisë huamarrëse, në administrim, “Gjallica”, caktohet, gjithashtu, administratore edhe në shoqëritë “Kamberi & Co”, “M.Leka”, “Global Foods”, “Fabiona”, “Univers”, “Arsed”, “Beno”, “Nahlel” dhe në fondacionet “Populli” dhe “Xhaferri”.

4. Z. Astrit Qerimi, administrator i shoqërisë huamarrëse, në administrim “Vefa”, caktohet, gjithashtu, administrator edhe në shoqëritë “Silva” dhe “Cenaj & Co”.

5. Ngarkohen Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse, në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.392, datë 28.6.2007

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të ndryshuar, dhe të pikës 6 të vendimit nr.566, datë 23.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Justina Boriçi, drejtore e Përgjithshme e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Besnik Maho emërohet drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

3. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.395, datë 28.6.2007

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT, NDËRTESESË E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE, NGA MINISTERIA E BRENDSHME TE MINISTERIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit, ndërtesës e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, nga Ministria e Brendshme të Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sipas formularit për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.404, datë 11.7.2007

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË POLONISË, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Polonisë, për bashkëpunimin ekonomik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.409, datë 11.7.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KRYERA, PËR TRAJTIMIN SHËNDETËSOR, NË TURQI, TË SË NDJERËS ZNJ. LORENA DRENOFCI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007. në artikullin “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 950 000 (nëntëqind e pesëdhjete mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kryera, për trajtimin shëndetësor, në Turqi, të së ndjerës znj.Lorena Drenofci.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Paguesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale, të lëshuara prej institucionit të kurimit.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.462, datë 18.7.2007

PER EMËRIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË QENDRËS KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 9 të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artin skenik”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Z. Gentian Çoçoli emërohet drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.465, datë 18.7.2007

**PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË TEATRIT KOMBËTAR TË
OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 9 të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artin skenik”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Zhani Ciko emërohet drejtor i Përgjithshëm i Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.479, datë 2.8.2007

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR KURIMIN, NË ITALI, TË
Z.BASHKIM GAZIDEDE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për kryerjen e operacionit të z.Bashkim Gazidede, në Itali.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. PAGESA TË KRYHET PAS PARAQITJES SË FATURAVE PËRKATËSE.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.485, datë 25.7.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KRYERJEN E TRANSPLANTIT TË VESHKS SË ZNJ.ERMA ZAGORÇANI, NË PAKISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 1 620 000 (një milion e gjashtëqind e njëzet mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve, për kryerjen e transplantit të veshkës së znj. Erma Zagorçani, në Pakistan.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Paguesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale, të lëshuara prej institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.487, datë 25.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.404, DATË 24.10.1991 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 9 e vendimit nr.404, datë 24.10.1991 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Presidenti i Republikës ka të drejtë të japë dhurata simbolike për personalitetet e larta, brenda dhe jashtë vendit, deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë në vit, ndërsa Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit deri në 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekë në vit. Nevojat mbi këto kuota miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Shpenzimet për dhurata përballohen nga vetë institucionet.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.510, datë 8.8.2007

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM AVOKATIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE TË DISA
MJEDISEVE TË NDËRTESESË (GODINËS) SË ISH-INIMA-S**


Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Dhënie në përdorim Avokatit të Prokurimeve Publike të disa mjediseve, në katin e parë, të ndërtesës së ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Kryeministria dhe Avokati i Prokurimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KATI I Pare SH 1:200



SIPERFAQE NE PERDORIM TE AVOKATIT TE PROKURIMEVE PUBLIKE



VENDIM
Nr.515, datë 15.8.2007

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT, NDËRMJET
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË
“CEMENTOS AGUILA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 44 e 69 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes minerare të shfrytëzimit, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Cementos Aguila” sh.p.k., sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE MINERARE E SHFRYTËZIMIT

E lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Kristo Rodi, Drejtor i Përgjithshëm, i autorizuar nga Ministri z.Genc Ruli dhe

“Cementos Aguila” sh.p.k., shoqëri e themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar me vendimin nr.36422, datë 30.10.2006, me seli në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Twin Towers (Kullat Binjake), nr.2, kati 11/3 Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z.Emilio Izquierdo Merlo.

Duke pasur parasysh që:

-*Në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit, Qeveria shqiptare i ka dhënë prioritet zhvillimit të zonave industriale, lidhur me aktivitetin minerar;*

-*Legjislacioni në fuqi, rregullon aktivitetet minerare dhe marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe personave juridikë që synojnë të përfitojnë nga legjislacioni minerar. Të gjitha të drejtat minerare të siguruara në përputhje me ligjin “Ligji minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994, të ndryshuar dhe ushtrimi i çdo aktiviteti minerar në Shqipëri bazohen në legjislacionin shqiptar dhe do të ushtrohen në përputhje me të;*

-*Qeveria e Shqipërisë mirëpret investitorët vendas dhe të huaj për shfrytëzimin e çdo vendburimi minerar, me qëllim nxjerrjen e minerareve duke përfshirë kërkimin, shfrytëzimin dhe zbulimin brenda një depozite minerare;*

-*Qeveria e Shqipërisë është deklaruar për një politikë të tërheqjes dhe mbështetjes së investimeve të huaja. Në zbatim të këtyre politikave ajo është e angazhuar t’i inkurajojë dhe mbështesë ata sa më gjerësisht që të jetë e mundur nëpërmjet sigurimit të bashkëpunimit të të gjitha autoriteteve shtetërore apo institucioneve të tjera nën kontrollin e saj, veçanërisht që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre duke iu përgjigjur brenda një kohe sa më të shkurtër kërkesave të personave juridikë sipas legjislacionit*

të Republikës së Shqipërisë. Ajo angazhohet që të bëjë të mundur që këto organe shtetërore dhe institucione të tjera të mos vonojnë në mënyrë të paarsyeshme aprovimin e tyre, për të siguruar zhvillimin e infrastrukturës së duhur nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për të mundësuar investimin për ngritjen dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos.

-*Qeveria e Shqipërisë* njeh si të vlefshme lejen minerare, e cila jepet nga ministri që mbulon veprimtarinë minerare duke bërë të mundur zhvillimin e aktivitetit minerar që lidhet me kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve.

-“Ligji minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, përcakton marrëdhënien ndërmjet shtetit shqiptar dhe personave juridikë që synojnë të përfitojnë të drejta në bazë të dispozitave të tij dhe të kryejnë aktivitete minerare.

-Ministri është i autorizuar të negociojë për nënshkrimin e një marrëveshjeje lehtësuese për investime, lartpërmendur me zotëruesin e lejes minerare, marrëveshje e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe në vijim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

-Ministri negocion marrëveshjen me zotëruesin e lejes minerare.

Zotëruesi i lejes minerare:

-Është seriozisht i interesuar të ushtrojë aktivitetin minerar dhe për përdorimin e produkteve minerare për qëllime industriale si lëndë të para për prodhimin e çimentos;

-Ka ndërmarrë studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt (siç përcaktohet në ligjin minerar të sipërpërmendur) dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos për qëllime industriale;

-Në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, do të ndërmarrë ndërtimin dhe vënien në funksion të fabrikës për prodhimin e çimentos dhe zhvillimin e infrastrukturës lidhur me të, duke investuar një shumë prej rreth 155 459 000, 00 eurosh (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë).

Palët:

Bien dakord që të bashkëpunojnë për shfrytëzimin e materialeve ndërtimore (gurit gëlqeror) në zonën gëlqerore Droje-Mamurras, në përputhje me lejet minerare me të cilat është pajisur shoqëria e sipërpërmendur zotëruese e lejes minerare dhe sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Neni 1 Përkufizime

Kudo ku janë përdorur termat e mëposhtëm në këtë Marrëveshje, respektivisht ato do të kenë kuptimet si vijon:

-Marrëveshje minerare e shfrytëzimit: Kjo marrëveshje me të gjitha përkufizimet;

-Zotëruesi i lejes minerare: Shoqëria “Cementos Aguila” sh.p.k.

-Periudha e shfrytëzimit minerar: Periudha kohore e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për 99 vjet;

-Zona minerare: Sipërfaqja e kërkuar nga zotëruesi i lejes minerare për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt, në zonën gëlqerore Droje-Mamurras, siç përcaktohet në lejen e shfrytëzimit minerar nr.1048, datë 31.7.2007. Koordinatat që përcaktojnë sipërfaqen e zonës minerare jepen në aneksin nr.1, bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje;

-Projekt: Studimi tekniko-ekonomik për shfrytëzimin minerar.

Neni 2
Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshjeje do të jetë dhënia zotëruesit e së drejtës për të ushtruar aktivitetet minerar në zonën minerare gjatë periudhës së shfrytëzimit minerar dhe, gjithashtu përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve për përmbushjen e kësaj marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 3
Kritere specifike të punimeve

Plani i investimit do të zbatohet nga zotëruesi i lejes minerare për një kohëzgjatje maksimale prej 4 (katër) vitesh, të cilat do të ndahen në 3 e (tri) faza, plus një fazë të tretë të mirëmbajtjes deri në fund të periudhës së shfrytëzimit minerar.

Faza e parë

Punimet përgatitore për hapjen e karrierave të gëlqerorit në gëlqerore Droje-Mamurras do të kryhen gjatë një periudhe prej katër (4) vitesh.

Faza e parë A): Studimet teknike të karrierave, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e mineraleve me një investim të përafërt gjatë vitit të parë prej 500 000 eurosh (pesëqind mijë).

Studimet teknike, projektimi dhe punimet përgatitore (shpimet gjeologjike dhe gjeoteknike, rrugët e hyrjes etj.) për hapjen e karrierave dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos kanë filluar. Faza e parë B). Blerja, montimi dhe fillimi i punës së impiantit të thyerjes që ndodhet në karrier. Makineritë e lëvizshme.

Vlera e përafërt e investimit në vitin e tretë: 800 000 (tetëqind mijë) euro dhe në vitin e katërt: 7 200 000 (shtatë milionë e dyqind mijë) euro, specifikuar sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Aktiviteti	Vlera e investimit në milionë euro
2007	Studimet teknike të karrierave, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e mineraleve	0.50
2009	Punimet në karriera për impiantin e thyerjes	0.80
2010	Pajisjet fikse, montimi dhe fillimi i punës. Pajisje të lëvizshme	7.20

Faza e dytë

Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e çimentos do të bëhet paralelisht me fazën e parë dhe gjatë një periudhe totale prej 4 vitesh, me një investim total prej rreth 146 950 000 (njëqind e dyzet e gjashtë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) eurosh.

Investimet që lidhen me karrierat do të kryhen paralelisht dhe do të përfundojnë jo më vonë se përfundimi i fabrikës për prodhimin e çimentos.

Investimet gjatë kësaj faze të dytë do të ndjekin radhën e treguar në tabelën në vijim:

Viti	Aktiviteti	Vlera e investimit në milionë euro
2007	Mbyllja e marrëveshjes për ndërtimin e fabrikës së prodhimit të çimentos, pagesa për kontraktorin (10%) Mbyllja e projektit të rrugëve ndërmjet karrierave dhe fabrikës, si dhe midis fabrikës dhe autostradës, paraqitja	6.89

	e dokumenteve dhe marrja e lejes. Punimet për kampin e punëtorëve të huaj. Fillimi i punimeve për fjetoret (shtëpitë).	
2008	Pagesa për kontraktorin (20%) Punimet dherash për fabrikën, fillimi i punimeve për rrugët e brendshme Ndërtimi i themeleve. Punime të tjera Instalimi i 50% të transformatorëve dhe rrjetit elektrik të tensionit të lartë. Ndërtimi i disa strukturave, mbarimi i konstruksionit të fabrikës, dhe shpimi për ujë Punime të tjera	28.91
2009	Punime dherash dhe punime përgatitore në karrierë për impiantin e thyerjes. Pagesa për kontraktorin (40%) Punime përgatitore dhe struktura Fillimi i punimeve për rrugët e jashtme Disenjimi i ndërtesave joprodhuese, aplikimi të autoritetet për marrjen e lejes. Fillimi i punimeve për ndërtimin e ndërtesave në fjalë 50% e transformatorëve dhe rrjetit elektrik të tensionit të lartë Konstruksione Punime të tjera	57.96
2010	Përfundimi i punimeve për ndërtesat prej betoni dhe i ngritjes së strukturave të çelikut dhe pajisjeve. Pagesa e fundit për kontraktorin (30%) Mbarimi i ndërtimit të rrugëve të jashtme Instalimet elektrike, elektronike dhe lidhja Mbarimi i ndërtimit të disa ndërtesave joprodhuese Testi pa ngarkesë dhe i prodhimit Fillimi i prodhimit Çmobilizimi i kampit të punëtorëve të huaj Të tjera	53.18

Faza e tretë

Punimet për mirëmbajtjen dhe investimet për rrugët e brendshme të karrierave të gëlqerorit të gëlqerore Droje-Mamurras do të bëhen gjatë periudhës së mbetur deri në fund të shfrytëzimit minerar sipas nevojës.

Vlera e mirëmbajtjes dhe investimeve gjatë kësaj faze të tretë llogaritet mbi shumën prej 3000 000 në vit gjatë gjithë ekzistencës së aseteve.

Bilancet vjetore do të përdoren si dokumente për monitorimin e investimit.

Neni 4

Fillimi i ndërtimit

Zotëruesi i lejes minerare duhet të fillojë ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos brenda 7 muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Një fillim i tillë do të kushtëzohet nga

disponueshmëria e tokës për qëllimet e ndërtimit të fabrikës për kohëzgjatjen e kësaj leje minerare të zgjatur, si dhe dhënien e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos nga të gjitha autoritetet kompetente.

Neni 5

Detyrimet dhe të drejtat e zotëruesit të lejes minerare

Zotëruesi i lejes minerare është i detyruar:

-Të zbatojë punimet për shfrytëzimin e karrierave në përputhje me projektin e investimit, sipas dispozitave të nenit 3, nëse autoritetet shtetërore kompetente nuk e kanë refuzuar padrejtësisht dhënien e të gjitha licencave dhe lejeve të nevojshme si për karrierat, ashtu edhe për fabrikën e prodhimin e çimentos.

-Të sigurojë ecurinë normale dhe drejtimin e punimeve, ndërsa do të mbajë ministrinë vazhdimisht të informuar përsa i përket procesit minerar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit minerar në fuqi.

-Të paguajë të gjitha detyrimet fiskale, taksat dhe pagesa e tjera që burojnë nga zbatimi i këtij aktiviteti ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

-Të zbatojë të gjitha aktet ligjore dhe normative në fuqi për mbrojtjen e ambientit në Republikën e Shqipërisë.

Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë:

Në përputhje me nenin 69 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, palët me qëllim që të sigurojnë një zhvillim të mirëbalancuar të aktivitetit minerar të shfrytëzimit në Shqipëri (hapjen e një karriere për materiale ndërtimi) dhe mbrojtjen në mënyrë të përshtatshme të investimit të zotëruesit të lejes minerare dhe aktivitetin e zotëruesit të lejes minerare në kuadër të investimit për ndërtimin dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos, bien dakord që zotëruesi i lejes minerare për një periudhë prej 99 vitesh nga firmosja e kësaj marrëveshjeje dhe aprovimi i saj nga Kuvendi i Shqipërisë do të ketë të drejtën ekskluzive të ushtrojë këtë aktivitet shfrytëzimi minerar në zonën minerare, sipas përcaktimeve të mësipërme.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

-Ministria garanton se ajo ka kompetenca dhe autoritet ligjor të plotë për të firmosur këtë marrëveshjeje:

-Ministria garanton përdorim të pacenuar dhe të papenguar të sipërfaqeve të tokës, objekt i kësaj marrëveshjeje, për periudhën e vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje.

-Ministria garanton që sipërfaqet e karrierave do të jenë të lira nga pretendime të palëve të treta për ndonjë peng, pengesë apo barrë të çfarëdo lloji, bazuar në shkresën nr.371, datë 3.8.2007 të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kurbin. Ministria merr përsipër që të ndihmojë Zotëruesin e lejes minerare për marrjen në rrugë ligjore të të gjitha lejeve dhe licencave për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos dhe të lidhjes rrugore të saj me karrierat dhe tregun, nga autoritetet shtetërore apo institucione të tjera nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të ndihmojë që këto leje të jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Kohëzgjatja e shfrytëzimit minerar

Ministria i garanton zotëruesit të lejes minerare të drejtën e shfrytëzimit të minerareve në zonën minerare për një kohëzgjatje prej 99 vitesh. Kjo periudhë kohore do të fillojë nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 8 Programi i punimeve

Zotëruesi i lejes minerare garanton se do të kryejë investimet e parashikuara në planin e ndërtimit dhe të shfrytëzimit me qëllim realizimin e objektit të kësaj marrëveshjeje. Projekti do të zbatohet sipas nenit 3 të kësaj marrëveshjeje dhe sipas planit përkatës të investimit të paraqitur.

Neni 9 Përfundimi i marrëveshjes së shfrytëzimit minerar

Ministria mund ta zgjidhë këtë marrëveshje kur ajo gjykon se kanë ndodhur shkelje të vazhdueshme të detyrimeve të ndërmarra nga zotëruesi i lejes minerare, të tilla që mund të bëjnë të pamundur vijimin e punimeve sipas parashikimit në planin e shfrytëzimit minerar.

Kur vihet re shkeljeje, ministria duhet ta njoftojë zotëruesin e lejes minerare rreth këtyre shkeljeve dhe të presë 30 ditë për një përgjigje shpjeguese.

Mosplotësimi i ndonjërit nga detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje nuk duhet të konsiderohet që është një shkelje e kësaj marrëveshjeje për sa kohë që kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një ngjarjeje që konsiderohet si forcë madhore, dhe kur është provuar se pala e prekur nga kjo ngjarjeje a) ka marrë të gjitha masat parandaluese të arsyeshme, si dhe të gjitha hapat e nevojshme për të zbatuar termat dhe konditat e kësaj marrëveshjeje; dhe b) ka informuar menjëherë palën tjetër për ndodhinë e kësaj ngjarjeje.

“Një ngjarje forcë madhore”, do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë apo kombinim i tyre që pengon plotësisht apo pjesërisht secilës nga palët për plotësimin e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje, vetëm nëse dhe në atë masë që një ngjarje apo rrethanë e tillë është përtej kontrollit të arsyeshëm direkt apo indirekt të palës së prekur, dhe nuk mund të ishte parandaluar nga çfarëdo masë të arsyeshme që kjo palë mund të kishte ndërmarrë.

Ngjarja forca madhore përfshin ngjarjet në vijim, por pa u kufizuar vetëm me to, me kusht që ato të plotësojnë termat e sipërpërmendur:

i) Çdo akt lufte (i deklaruar apo jo), luftë civile, pushtim, konflikt i armatosur apo veprim i armikut të jashtëm, kryengritja apo terrorizëm që përfshijnë apo ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Shqipërisë;

ii) Revolucioni, protesta, rebelim ose çdo lloj revolte civile, akte terrorizmi apo sabotazhi, të cilat në çdo rast përfshijnë apo ndikojnë direkt Republikën e Shqipërisë;

iii) Greva të shpërndara gjerësisht dhe/ose në shkallë, politike, kombëtare;

iv) Kontaminim bërthamor, kimi ose biologjik, të cilat direkt apo indirekt ndikojnë sipërfaqen objekt të kësaj marrëveshjeje, përveç rasteve kur shkaku i këtij kontaminimi vjen si rezultat i veprimeve të shoqërisë ose kontraktorëve të saj;

v) Epidemitë ose infeksionet, të cilat direkt ose indirekt ndikojnë në zonën e koncesionit.

Në raste vonesash të shkaktuara nga ministria ose nga ndonjë organ tjetër shtetëror, i cili kryen funksionet e tij në lidhje të drejtpërdrejtë me lëshimin e licencave dhe lejeve të tjera ndërtimore të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos ose vonesa të pajustificuara të shkaktuara nga organe të tjera qeveritare gjatë kryerjes së funksioneve që lidhen me këtë marrëveshje dhe nuk janë nën kontrollin e shoqërisë, periudha e vonesës nuk do të llogaritet në kuadrin e afateve kohore të vendosura më sipër.

Në rastet e forcës madhore, afate kohore të përmendura në nenin 3 të mësipërm për zotëruesin e lejes minerare do të shtyhen në përputhje me të, por në asnjë rast kjo nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës së shfrytëzimit minerar, e cila mund të shtyhet vetëm sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 10
Kontrolli dhe investimi

Ministria ka të drejtën dhe detyrimin që të kontrollojë rregullisht zbatimin e marrëveshjes sipas kushteve të parashikuara në të dhe në përputhje me detyrimet e saj që rrjedhin nga “Ligji Minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994.

Ministria dhe zotëruesit e lejes minerare do të përcaktojnë së bashku mënyrën më të mirë të kontrollit, duke siguruar në të gjitha rastet që ky aktivitet nuk do të paraqesë ndërhyrje të paarsyeshme në zbatimin e projekteve. Zotëruesi i lejes minerare do të japë çdo shpjegim teknik që kërkohet.

Zotëruesi i lejes minerare do të vërë në dispozicion të ministrisë pasqyrat financiare vjetore të tij, të hartuara në përputhje me standardet e kontabilitetit, me qëllim verifikimin e zbatimit të investimit sipas kësaj marrëveshjeje.

Në çdo rast kur ministria identifikon shkelje, ajo do t’ia komunikojë me shkrim, në mënyrë mjaft të hollësishme, vërejtjet dhe gjetjet e saj zotëruesit të lejes minerare, me kërkesën që punimet duhet të vazhdohen sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje.

Neni 11
Ligji aplikueshëm

Kjo marrëveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Ministria garanton se të drejtat e zotëruesit të lejes minerare sipas kësaj marrëveshjeje që lidhen me shfrytëzimin e karrierave për një periudhë prej 99 vitesh dhe përdorimi i tokës për një periudhë prej 99 vitesh do të zgjasë dhe do të vijojnë të qëndrojnë në fuqi, pavarësisht çdo ndryshimi të dispozitave ligjore që lidhen me to, të aplikuara në Shqipëri që do të hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje, e cila mund të lindë nga dhe në lidhje me këtë marrëveshje gjatë zbatimit të saj, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok ndërmjet palëve do të zgjidhet përfundimisht nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar, në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), nga një apo tre arbitra, që do të emërohen sipas rregullave të sipërpërmendura.

Vendi i arbitrazhit do të jetë në Paris, Francë dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglisht.

Neni 13
Bashkëpunimi

Ministria dhe zotëruesi i lejes minerare bien dakord që të bashkëpunojnë me qëllimin për të garantuar zbatimin e projektit siç është përcaktuar në këtë marrëveshje.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera ndërmjet palëve duhet të dërgohen në adresat respektive të palëve.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas firmosjes së saj nga palët, dhe pasi ajo të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe më pas të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar.

Aneksi nr.1

Koordinatat e zonës së shfrytëzimit dhënë me leje minerare nr.1048, datë 31.7.2007

NR.	Y	X
1.	43 92 632	46 02 900
2.	43 92 632	46 03 120
3.	43 92 785	46 03 120
4.	43 92 785	46 03 105
5.	43 92 835	46 03 105
6.	43 92 835	46 03 155
7.	43 92 785	46 03 155
8.	43 92 785	46 03 140
9.	43 92 632	46 03 140
10.	43 92 632	46 03 470
11.	43 92 525	46 03 675
12.	43 92 200	46 03 750
13.	43 92 170	46 03 850
14.	43 92 000	46 03 870
15.	43 91 800	46 04 000
16.	43 91 800	46 04 400
17.	43 91 880	46 04 450
18.	43 91 920	46 04 425
19.	43 92 065	46 04 425
20.	43 92 065	46 04 500
21.	43 92 050	46 04 500
22.	43 92 050	46 04 600
23.	43 92 250	46 04 800
24.	43 92 350	46 04 800
25.	43 92 475	46 04 700
26.	43 92 575	46 04 675
27.	43 92 600	46 04 700
28.	43 92 600	46 04 750
29.	43 92 690	46 04 775
30.	43 92 800	46 04 780
31.	43 92 810	46 04 585
32.	43 92 750	46 04 575
33.	43 92 725	46 04 500
34.	43 92 750	46 04 475
35.	43 92 830	46 04 490
36.	43 92 850	46 04 350
37.	43 92 700	46 04 000
38.	43 92 600	46 03 900
39.	43 92 550	46 03 850
40.	43 92 525	46 03 700
41.	43 92 650	46 03 475
42.	43 92 800	46 03 500
43.	43 93 040	46 03 450
44.	43 93 040	46 02 900

VENDIM
Nr.518, datë 25.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.590, DATË 22.12.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E DY ANËTARËVE NË KËSHILLIN ADMINISTRATIV TË
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i dytë i vendimit nr.590, datë 22.12.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ministri i Shëndetësisë, si përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 519, datë 25.7.2007

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 44 e 69 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes minerare të shfrytëzimit, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Antea Cement” sh.a., sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.526, datë 22.8.2007

PËR FUNKSIONIMIN E KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR ÇËSHTJET ME ORGANIZATËN E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT (NATO)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e funksionit të Koordinatorit Kombëtar për Çështjet me NATO-n, për bashkërendimin ndërinstitucional në marrëdhëniet me NATO-n dhe të veprimtarive të anëtarësimit në këtë organizatë.

2. Koordinatori Kombëtar bashkërendon veprimtaritë e Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe institucioneve qendrore, me strukturat përgjegjëse të zyrës së Presidentit të Republikës, Kuvendit dhe institucionet e pavarura, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të shtetit shqiptar me NATO-n.

3. Koordinatori Kombëtar organizon, bashkërendon dhe ndjek zbatimin e detyrave, të ministrive dhe institucioneve qendrore. Që rrjedhin nga angazhimet për anëtarësimin në NATO.

4. Koordinatori Kombëtar kryeson grupin ndërministror të punës, që krijohet me urdhër të Kryeministrit, në nivel zëvendësministrash, për hartimin dhe monitorimin e planit të veprimit, për anëtarësim në NATO.

5. Për përmbushjen e funksionit, Koordinatori Kombëtar ka këto detyra dhe të drejta:

a) Me porosi dhe/ose me dijeni të Kryeministrit ose në bazë të detyrave të MAP-it, komunikon dhe shkëmben të dhëna me zyrën e Presidentit të Republikës, Kuvendin dhe institucionet e tjera, të pavarura.

b) Komunikon drejtpërdrejt me ministrat dhe titullarët e institucioneve qendrore, për t’u përcjellë porosinë e Kryeministrit, për marrjen e të dhënave dhe për çështjet, që mund të dalin gjatë ndjekjes së zbatimit të detyrave, në kuadër të procesit të integritimit në NATO etj.

c) Vë në dijeni Kryeministrin dhe merr porosi prej tij, në çdo rast, për kontaktet me strukturat e NATO-s.

ç) Vë në dijeni, periodikisht, Kryeministrin, për rezultatet e kontakteve me strukturat e NATO-s, si dhe jep vlerësim e mendim, për ecurinë e realizimit të detyrave, nga institucionet shtetërore, në kuadër të procesit të anëtarësimit në NATO.

d) Pajiset me vulë zyrtare të veçantë për dokumentet shkresore, të nënshkruara prej tij.

dh) Inventarizon dhe tërheq të gjithë dokumentacionin shkresor për/nga NATO-ja, të administruar nga institucionet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 5, si dhe kërkon informacion nga institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi. Dokumentacioni ruhet dhe qarkullon nëpërmjet protokollit të Kryeministrisë.

6. Koordinatori Kombëtar e ushtron veprimtarinë pranë Këshillit të Ministrave. Për përmbushjen e detyrave, koordinatori kombëtar ndihmohet nga koordinatorët dhe asistenti, të cilët organizohen si njësi e veçante, në përbërje të Kryeministrisë. Njësia do të funksionojë deri në shkrirjen e funksionit të Koordinatorit Kombëtar, me anëtarësimin e vendit tonë në NATO.

Marrëdhëniet e koordinatorëve dhe të asistentit rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

7. Koordinatori Kombëtar, koordinatorët dhe asistenti emërohen dhe lirohen nga detyra me urdhër të Kryeministrit.

8. Koordinator Kombëtar njësohet në pagë dhe në trajtimet e tjera me funksionin e drejtorit të kabinetit të Kryeministrit dhe, në nivel protokollar, me funksionin e zëvendësministrit, ndërsa koordinatorët dhe asistenti njësohen në page, përkatësisht, me funksionin drejtor në ministri, (II-b)” dhe “Specialist, (IV-a)”.

Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet e përmendura në këtë vendim, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 527, datë 27.8.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, shkronja “c”, 20, shkronjat “ë” dhe “g”, e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe të neneve 76-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në paragrafin e fundit, të pikës 2 të kreut I të vendimit nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, data “...27 gusht 2007” zëvendësohet me “... 31 gusht 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.532, datë 28.8.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 83 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në shtetet e përcaktuara në shkronjën “b” të lidhjes nr.8, që i bashkëlidhet vendimit “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, në listën “Vendet, shtetasit e të cilëve hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, duke paguar taksën e hyrjes (kur udhëtojnë me pasaportë të thjeshtë)”, të shtohet edhe “Kili”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.539, datë 22.8.2007

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, PËR ZHVILLIMIN E
AUTOSTRADAVE TË DETEVE NË RAJONIN E BSEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, për zhvillimin e autostradave të deteve, në rajonin e BSEC-ut.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.540, datë 22.8.2007

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET QEVERIVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS, REPUBLIKËS SË
BULLGARISË, REPUBLIKËS SË KROACISË, ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË
MAQEDONISË, REPUBLIKËS SË MOLDAVISË, REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI,
RUMANISË DHE REPUBLIKËS SË SERBISË “PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN
KUNDËR KORRUPSIONIT, NËPËRMJET NISMËS ANTIKORRUPSION TË EUROPËS
JUGLINDORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverive të Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, të Republikës së Moldavisë, Republikës së Malit të Zi, Rumanisë dhe Republikës së Serbisë “Për bashkëpunimin në luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet nismës antikorrupsion të Europës Juglindore”.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET QEVERIVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS, REPUBLIKËS SË BULLGARISË, REPUBLIKËS SË KROACISË, ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË, REPUBLIKËS SË MOLDAVISË, REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI, RUMANISË DHE REPUBLIKËS SË SERBISË, MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT, NËPËRMJET INICIATIVËS ANTIKORRUPSION TË EUROPËS JUGLINDORE

Qeveritë e Republikës së Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Malit të Zi, Republikës së Moldavisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë,

Këtu e tutje të referuara si “Palët”,

duke riafirmuar së bashkëpunimi rajonal është një kusht i domosdoshëm për forcimin e stabilitetit, sigurisë e zhvillimit social dhe ekonomik në Europën Juglindore, edhe nëpërmjet aktivitetit ndërkufitar kundër korrupsionit;

duke pranuar se arritja e anëtarësimit në Bashkimin Europian do të kërkojë përpjekje kombëtare në rritje brenda fushës së luftës kundër korrupsionit nga të gjitha vendet e interesuara;

duke sjellë ndër mend Planin e marrëveshjes dhe veprimit të iniciativës kundër korrupsionit të paktit të stabilitetit (SPAI), Deklaratën e Londrës të vitit 2002 mbi luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, deklaratën e Selanikut të Ballkanit Perëndimor dhe Deklaratën e Përbashkët JHA SEECF 2004;

duke pranuar progresin e bërë nga vendet pjesëmarrëse në zbatimin e masave kundër korrupsionit, të miratuara në Deklaratën Ministeriale SPAI 2005 mbi 10 masa të përbashkëta për uljen e korrupsionit në Europën Juglindore;

duke pranuar se krijimi i Zyrës Ndërlidhëse të Sekretariatit Rajonal SPAI (SPAI RSLO) në tetor 2003, përfaqëson një shprehje konkrete dhe të dukshme të angazhimit të shteteve rajonale për të bashkëpunuar dhe koordinuar luftën e tyre kundër korrupsionit në Europën Juglindore;

duke sjellë ndër mend Përfundimet e Tryezës Rajonale dhe Takimeve të tryezës së Punës, të mbajtura në 2006 në Beograd dhe Bukuresht, si dhe Vendimet e Grupit të 10-të Drejtues SPAI, Beograd, 30 maj 2006, në lidhje me financimin e SPAI,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Drejtimi i SPAI

Palët bien dakord të pranojnë përgjegjësinë e përbashkët për SPAI-n dhe të sigurojnë stabilitetin financiar të aktiviteve të SPAI RSLO.

Grupi Drejtues Rajonal është organi vendimmarrës i SPAI që vendos mbi programin dhe buxhetin vjetor dhe takohet një herë në vit dhe kurdoherë që është e nevojshme.

Anëtarë e Grupit Drejtues Rajonal mund të vendosin të ftojnë vendet dhe organizatat partnere si vëzhgues në takimet e tyre.

Çdo vit, një zyrë drejtuese për SPAI-n do të emërohet nga rajoni nga Grupi Drejtues Rajonal. Zyra e parë drejtuese do të emërohet sa më parë të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi. Zyra drejtuese do të kryesojë takimet e Grupit Drejtues Rajonal, do të sigurojë bashkërendim dhe mbikëqyrje të përgjithshme të aktiviteve të SPAI RSLO-s në emër të Grupit Drejtues Rajonal dhe do të raportojë takimet e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit.

Pas përfundimit të Paktit të Stabilitetit dhe krijimit të Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit, Zyra Drejtuese do të raportojë takimet e Këshillit.

Palët riafirmojnë në pajtim me Deklaratën Ministeriale SPAI 2005 mbi 10 masat e përbashkëta për uljen e korrupsionit në Europën Juglindore, angazhimin e tyre për të mbështetur dhe konsoliduar cilësinë e SPAI RSLO-s për të vepruar si Qendra e Burimit Antikorrupsion të Europës Juglindore dhe për të shërbyer si pikë referimi për bashkëpunimin rajonal kundër korrupsionit, nëpërmjet lehtësimit të praktikave më të mira dhe shpërndarjes së mësimëve të nxjerra.

Palët gjithashtu riafirmojnë në pajtim me Deklaratën Ministeriale SPAI 2005, mbi 10 masat e përbashkëta për uljen e korrupsionit në Europën Juglindore, angazhimin e tyre për të forcuar rolin e përfaqësuesve të lartë si koordinatorë kombëtarë për antikorrupsionin dhe pika referimi për partnerët ndërkombëtare duke u dhënë atyre mbështetje politike dhe burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.

Neni 2

Financimi i buxhetit operacional dhe programatik i SPAI-t

Palët bien dakord të kontribuojnë çdo vit, duke filluar nga viti 2007, me një shumë minimale prej 24 000 euro për buxhetin operacional dhe programatik të SPAI-t, duke siguruar në këtë mënyrë stabilitetin financiar të SPAI RSLO-s.

Kontributi i parë financiar do të transferohet në llogarinë bankare të SPAI RSLO-s, të përmendur më poshtë, sa më parë të jetë e mundur, tre muaj pas nënshkrimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Më pas, kontributet financiare vjetore do të transferohen brenda tremujorit të parë të çdo viti.

PËRFITUESI: SPAI RSLO 2

LLOGARIA NË EURO: 503022 136623

BANKA E PËRFITUESIT: VOLKSBANK BH DD SARAJEVË

SWIFT CODE: VBSABA22

BANKA NDËRMJETËSE: DEUTSCHE BANK

LLOGARIA NË EURO: 936 537 000

SWIFT CODE: DEUTEFF

SPAI RSLO do të njoftojë menjëherë Palët për çdo ndryshim në lidhje me procedurat e pagesës.

Palët bien dakord që në rast se kontributet e alokuara për një vit fiskal nuk janë shpenzuar tërësisht, bilanci do të përfshihet automatikisht në buxhetin e SPAI RSLO-s për vitin e ardhshëm fiskal, pa marrëveshje paraprake zyrtare.

Përveç kontributeve vjetore nga Palët, SPAI do të vazhdojë të kërkojë mbështetjen e donatorëve për aktivitete specifike programatike brenda programit të SPAI-it.

Neni 3

Raportet dhe kontrolli financiar

SPAI RSLO do t'i dorëzojë Grupit Drejtues Rajonal çdo vit raporte që përshkruajnë zbatimin e programit dhe të gjitha shpenzimet buxhetore të përfshira.

SPAI RSLO do të kryejë çdo vit një kontroll financiar të pavarur. Rezultatet dhe rekomandimet e kontrollit financiar duhet t'i paraqitet Grupit Drejtues Rajonal për rishikim dhe çdo palë tjetër që ka dhënë kontribut financiar për buxhetin e SPAI-t.

Neni 4

Kohëzgjatja, përfundimi dhe depozitimi i Memorandumit

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të miratohet nga Palët në përputhje me procedurat e brendshme ligjore dhe do të hyjë në fuqi ditën e pas muajit në të cilin pala e fundit ka njoftuar depozitarin mbi përfundimin e procedurave të nevojshme për atë qëllim.

Nëse kërkesat e brendshme ligjore e lejojnë, çdo palë mund të zbatojë përkohësisht këtë Memorandum mirëkuptimi nga data e nënshkrimit të tij. Zbatimi i përkohshëm sipas këtij paragrafi do t'i njoftohet depozitarit.

Republika e Kroacisë do të veprojë si shteti depozitar.

Ku Memorandum mbetet në fuqi për tre vjet dhe do të shtyhet automatikisht për një periudhë tjetër trevjeçare, për sa kohë që palët nuk bien dakord ndryshe.

Çdo palë mund të denoncojë këtë Memorandum me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar shtetit depozitar. Shteti depozitar është i detyruar të informojë të gjitha palët brenda 15 ditësh në lidhje me marrjen e këtij njoftimi. Denoncimi do të ketë efekt tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit.

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve mbi interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi, duke përfshirë vlefshmërinë ose përfundimin e tij, do të zgjidhet me anë të bisedimeve ndërmjet palëve.

Pavarësisht nga përfundimi i këtij Memorandumi, dispozitat e tij do të vazhdojnë të zbatohen në shkallën e nevojshme, për të lejuar përfundimin e aktiviteteve specifike, tashmë të ndërmarra sipas Memorandumit.

Teksti origjinal i Memorandumit në një kopje të vetme në gjuhën angleze do të depozitohet në Republikën e Kroacisë si shteti depozitar që do t'i transmetojë një kopje të vërtetuar çdo pale.

Nënshkruar më 13 prill 2007 në Zagreb, Republika e Kroacisë.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht nga Qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Ministrat e vendeve anëtare të SPAI-it

VENDIM

Nr.542, datë 22.8.2007

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT NR.35853/04, DATË 12.12.2006 TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, PËR ÇËSHTJEN “BAJRAMI KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të konventës europiane “Për të drejtat e njeriut”, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për të drejtat e njeriut dhe të lirive themelore”, dhe të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit nr.35853/04, datë 12.12.2006 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen “Bajrami kundër Shqipërisë” në shumën 25 000 (njëzet e pesë mijë) euro.
2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave.
3. Shuma prej 25 000 eurosh, së bashku me interesat e mospagimit në afat të depozitohen në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit “Bajrami”, dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën kur do të çelet llogaria.

4. Fondi i përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, t'i shtohet Ministrisë së Financave, zëri "Shpenzime korente", dhe pagimi i shumës së depozituar të bëhet përkundrejt paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit

5. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.544, datë 15.8.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.151, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR STATUSIN "DËSHMOR I ATDHEUT"", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 14, e 20 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.151 datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "b" e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Komisioni Qendror i statusit "Dëshmor i Atdheut" mbështetet nga një staf teknik, që funksionon pranë Ministrisë së Mbrojtjes, përbërja e të cilit përcaktohet nga Ministri i Mbrojtjes.

Përgjegjësi i këtij stafi ushtron funksionet e sekretarit të Komisionit Qendror të statusit "Dëshmor i Atdheut".

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën "a" bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i) Pas fjalëve "...këshillit të qarkut..." shtohen "... ose të prefektit..."

ii) Fjalët "... në Departamentin e Veteranëve dhe të Invalidëve të LANÇ-it dhe të statusit "Dëshmor i Atdheut" .. ." zëvendësohen me "... pranë stafit teknik të Komisionit Qendror të statusit "Dëshmor i Atdheut"...."

b) Paragrafi i dytë i shkronjës "b" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Kërkesën, në emër të familjes, e paraqet njëri nga pjesëtarët, bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët përfitues, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare, në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut."

"c) Shkronja "c" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ç) Komisioni Qendror për statusin "Dëshmor i Atdheut", pasi shqyrton kërkesën dhe dokumentet përkatëse, së bashku me relacionin e stafit teknik, që përmban një përshkrim të shkurtër të jetës dhe veprimtarisë së personit, vlerësimin e dokumenteve shtetërore, që vërtetojnë kërkimin dhe njohjen e statusit "Dëshmor i Atdheut", bazën ligjore mbi të cilën mbështetet kërkesa, për njohjen këtij statusi, si dhe mendimin për përfitimin ose jo e statusit "Dëshmor i Atdheut", merr vendim për njohjen ose jo të këtij statusi dhe njofton të interesuarin."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.556, datë 29.8.2007

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Neritan Alibali, zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Ekrem Spahia të emërohet zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.557, datë 29.8.2007

PËR EMËRIM NË DETYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Z. Neritan Alibali të emërohet zëvendësministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.558, datë 19.7.2007

PËR SHPALLJEN E GJENDJES SE EMERGJENCËS NË DISA QARQE TË VENDIT, PËR SHKAK TË ZJARREVE MASIVE NË PYJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, dhe të neneve 36 e 37 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës civile për shkak të zjarreve në pyje, në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe Lezhë, duke filluar nga data 24.7.2007.

2. Krijimin e Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile, të kryesuar nga zëvendëskryeministri.

3. Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile të ketë në përbërje Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Shëndetësisë, Ministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe zëvendësministrin e Brendshëm.

4. Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile të shfrytëzojë të gjitha kapacitetet ekzistuese shtetërore dhe të marrë me qira, kur nuk disponon, mjete, në mënyrë që situata në pyje të vihet nën kontroll, në një kohë sa më të shkurtër.

5. Ministrinë e linjës dhe të gjitha institucionet e tjera shtetërore të vënë në dispozicion të Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile të gjitha burimet, që kanë.

6. Prefektët e qarqeve të ngrënë komisionet e planifikimit dhe të përballimit të emergjencave, për menaxhimin e situatës së krijuar.

7. Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile ta njoftojë, çdo ditë, Kryeministrin për situatën dhe punën e bërë në shuarjen e zjarreve në pyje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.565, datë 5.9.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E Z.ARTUR MICI, NË ITALI

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në Itali, të z.Artur Mici.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. PAGESA të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucioneve të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.570, datë 5.9.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT AVNI HALIT DURIÇI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, grupi 25, titulli 10430, kap 1, artikulli 606 “Transferta të brendshme”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjes së shtetasit Avni Halit Duriçi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.572, datë 5.9.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT BESNIK AHMET ALLIU

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, grupi 25, titulli 10 430, kap 1, artikulli 606, “Transferta të brendshme”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjes së shtetasit Besnik Ahmet Alliu.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.573, datë 5.9.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT ZAIM HAKI HYSA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabartam, në buxhetin e miratur për vitin 2007, grupi 25, titulli 10430, kap 1, artikulli 606 “Transferta të brendshme”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjes së shtetasit Zaim Haki Hysa.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.574, datë 5.9.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT MEHDI LAIM JANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, grupi 25, titulli 10430, kap 1, artikulli 606 “Transferta të brendshme”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjes së shtetasit Mehdi Laim Jani.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.575, datë 5.9.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT HYSEN HAQIF LEZI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, grupi 25, titulli 10 430, kap 1, artikulli 606 “Transferta të brendshme”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjes së shtetasit Hysni Haqif Lezi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.583, datë 5.9.2007

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LITUANISË, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Lituanisë, për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.585, datë 5.9.2007

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË, PËR
BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, për bashkëpunimin për zhvillim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**MBI BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë, këtu të quajtura “Palët”,

duke marrë parasysht udhëzimet e Komitetit të Asistencës për Zhvillim të OECD-së (DAC), marrëdhëniet bashkëpunuese të Bashkimit Europian dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Europës Lindore (këtu quhen “Rajoni”) dhe marrëveshjet kuadër ekzistuese, dhe duke riafirmuar përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar në zonë,

duke vënë re rëndësinë e një qëndrimi rajonal për zhvillimin, duke synuar në kontributin për paqe, siguri, përparim dhe stabilitet në rajon,

duke synuar themelimin e një marrëdhënieje kontraktuale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Sllovenisë, bazuar në partneritet dhe transparencën e bashkëpunimit për zhvillimin, me objektivin e kontributit për zhvillimin ekonomik dhe orientimit europian të Republikës së Shqipërisë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Objektivat

Fushat e synuara të bashkëpunimit për zhvillimin janë si më poshtë:

- a) Modernizimi i infrastrukturës, rehabilitimi, përmirësimi dhe mbrojtja e ambientit, dhe aftësi e përmirësuar për të vepruar në raste të fatkeqësive natyrore dhe të tjera;
- b) Nxitja e investimeve prodhuese;
- c) Modernizimi i administratës publike dhe vetëqeverisja lokale;
- d) Mbështetja për ndërtimin e institucioneve demokratike;
- e) Mbështetja për shtetin ligjor;
- f) Mbështetja për përmirësimet në politikën sociale;

- g) Inkurajim i zhvillimit ekonomik;
 - h) Mbështetje për arsimin dhe trajnimin profesional të potencialeve administrative dhe shkencore;
 - i) Dhënia e bursave;
 - j) Mbështetje për zhvillimin në fushën e arsimit, trajnimit dhe çështjeve të rinisë, veçanërisht në kuadrin e programeve multilaterale të bashkëpunimit;
 - k) Trajnimi dhe edukimi i burimeve njerëzore, administrative dhe shkencore për pjesëmarrjen në kërkimet europiane dhe programet e zhvillimit, veçanërisht në programet e Programit Kuadër të 6-të të BE-së;
 - l) Pjesëmarrje në projektet e përbashkëta, të regjistruara nga organizatat sllovene brenda kuadrit të kërkimeve europiane dhe programeve, me theks të veçantë mbi trajnimin dhe punën kërkimore dhe në Slloveni,
 - m) Mbështetje për trajnimin e personelit të administratës shtetërore me qëllim përafrimin me BE-në;
 - n) Reforma në financat publike.
- Format e veçanta të bashkëpunimit për zhvillimin që bazohen në këtë marrëveshje përfundohen në memorandume bashkëpunimi që përfundon ndërmjet zotëruesve ose kontraktorëve të projekteve dhe programeve dhe përfituesit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Fondet

Brenda kuadrit të bashkëpunimit të zhvillimit, Republika e Sllovenisë i jep Republikës së Shqipërisë asistencë për zhvillimin që përcaktohet nga vlera e programeve dhe projekteve të planifikuara në bazë të memorandumeve që përmenden në nenin 1 të saj.

Iniciativa për ekzekutimin e një programi ose projekti të veçantë merret ose nga Komiteti i Përbashkët i përmendur në nenin 6 të këtushëm ose nga zotëruesit apo kontraktorët individualë të një aktiviteti ose projekti të caktuar zhvillimi.

Neni 3

Vlerësimi dhe monitorimi

Në vlerësimin dhe monitorimin e programeve dhe projekteve të zhvillimit, Palët përmbushin kriteret dhe procedurat e zbatuara nga Bashkimi Europian.

Neni 4

Përputhshmëria me politikën e Komunitetit Europian

Në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, Republika e Sllovenisë respekton detyrimet e saj që rrjedhin nga *acqui-s* e Bashkimit Europian.

Projektet dhe aktivitetet e financuara në bazë të programit të asistencës për zhvillimin përputhen me politikën e Bashkimit Europian, duke përfshirë ato në lidhje me mbrojtjen e ambientit, barazinë gjinore, transportin, rrjetet transeuropiane (TREN) konkurrencën, si dhe prokurimin publik.

Neni 5

Bashkëndimi me donatorë të tjerë

Palët bien dakord që vende të tjera dhe/ose organizata ndërkombëtare si nga sistemi i zhvillimit të OKB-së dhe të tjera, si dhe institucione të tjera bashkëpunimit rajonal mund të marrin pjesë në mbështetjen financuese për zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Mbështetja financiare nga partnerët e tjerë nuk kalon 90 për qind të vlerës së përgjithshme të projektit.

Neni 6

Komiteti i përbashkët

Një Komitet i Përbashkët ngrihet për të propozuar prioritetet, programet dhe projektet e bashkëpunimit ndërkombëtar të zhvillimit, duke marrë parasysh vlerësimin e projekteve dhe programeve të bashkëpunimit për zhvillimin që tashmë janë përfunduar. Komiteti i Përbashkët përbëhet nga dy anëtarë nga secila Palë.

Për Qeverinë e Republikës së Sllovenisë, anëtarët e Komitetit të Përbashkët emërohen nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë nga Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Neni 7

Pengesat dhe forca madhore

Në rastin e pengesave në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për shkak të forcës madhore, të njohur nga Palët, (si lufta, trazira civile ose fatkeqësi natyrore), palët mund të bien dakord për pezullimin e përkohshëm të programeve dhe projekteve që po zbatohen.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

Amendimet

Palët mund të amendojnë këtë Marrëveshje. Çdo amendim i tillë hyn në fuqi në pajtim me procedurën e parashikuar në nenin 10, paragrafi 1.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me marrjen e njoftimit të fundit nga dy njoftimet me të cilat Palët njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e tyre të brendshme që kërkohen për hyrjen e saj në fuqi janë përfunduar.

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe, nëse një Palë nuk e prish atë me njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja pushon së zbatuari gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.

Bërë në _____ në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbraja ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 21.7.2010

Doli nga shtypi më 23.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 38 lekë